**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA**
**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**

01 Nr. 2584
Rahovec, 19.08.2016

Në bazë të nenit 12. Paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 2 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01Nr 569/1 i datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 19.08.2016 , merr këtë:

# VENDIM

## Për aprovimin e Planit të investimeve në hapësira e hapura publike në komunën e Rahovecit 2016 - 2021

I. Aprovohet **Plani i investimeve në hapësirat e hapura publike në komunën e Rahovecit 2016-2021.**

II. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës dhe drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit

III. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, nenit 8, të Rregullores së (QRK), Nr-01/2016, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

***Me vendim të njoftohen:***

1. *Zyra e Kryetarit,*
2. *Shërbimi i Kuvendit*
3. *Drejtoria për Shërbime Publike, dhe*
4. *Arkivi*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 2584 Më / Dt. 19.08.2016
RAHOVEC - ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, RAHOVEC, Skupština Opštine Orahovac, ORAHOVAC, REPUBLIKA KOSOVA

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Nahit Elshani**

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo**

**Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec**

# Plani i Investimeve në Hapesirat e Hapura Publike në Komunen e Rahovecit 2016-2021

---

Autor: Grupi punues

Korrik 2016

*Rahoveci është komunë partnere në programin DEMOS i cili përkrahet nga Qeveria Zvicerane gjegjësisht SDC (Sëiss Agency for Development and Cooperation) dhe implementohet nga Helvetas Sëiss Intercooperation, i orientuar në mbeshtetje të krijimit dhe mirëmbajtjes së hapesirave publike, vlerësimit, planifikimit, monitorimit të sheërbimeve, zbatimit dhe ndërgjegjësimit publik lidhur me HHP.*

**Lista e shkurtesave:**

| | |
|---|---|
| DEMOS | Decentralization and Municipal Support |
| SDC | Sëiss Agency for Development and Cooperation |
| GIS | Geographical Information System |
| KKR | Kuvendi Komunal Rahovec |
| GQ | Grant Qeveritar |
| HHP | Hapesirat e Hapura Publike |
| PMHHP | Plani i Mirembajtjes se Hapesirave te Hapura Publike |
| PIHHP | Plani i Investimeve ne Hapesirat e Hapura Publike |
| PZhK | Plani Zhvillimor Komunal |
| PZhU | Plani Zhvillimor Urban |
| PRrU | Plani Rregullues Urban |

**Lista e figurave - grafiqeve:**


*Fig. 1* *Paraqitja grafike e siperfaqeve aktuale te HHP ne qytetin e Rahovecit dhe raporti i tyre ne perqindje per tipologjite e trajtuara ne plan*

*Fig. 2* *Investimet ne te kaluaren ne zonen urbane dhe rurale*

*Fig. 3* *Investimet e parashikuara ne HHP ekzistuese 2016-2021 ne z. urbane dhe ne z. rurale*

*Fig. 4* *Investimet ne HHP te reja te parashikuara - 2016-2021 ne zonen urbane*

*Fig. 5* *Investimet ne HHP te planifikuara - 2016-2021 ne zonen rurale*

*Fig.6* *Harta e HHP në të cilat janë planifikuar investimet*

## 1. Hyrje

HHP kanë pa dyshim rol të veçanteë në definmin e funkcioneve kulturore, shoqërore, ekonomike, politike, dhe paraqesin vijat kryesore të portretit të venbanimeve në pergjithesi. Tani më edhe tek ne, ato kane filluar të trajtohen si elemente primare, tregues i statusit të venbanimeve dhe të cilat në të vërtete sigurojnë atributin e qytetiit të zhvilluar dhe të planifikuar mirë.

Gjatë planifikimit të qyteteve, rëndesia e HHP anashkalohet shpesh dhe për kete ekzistojnë një serë arsyesh si: mungesa e fondeve dhe burimeve financiare, peërceptimi ende jo adekuat i kapaciteteve dhe mundësive për të shfrytezuar ato si terësi hapësinore dhe si sisteme shumëfunkcionale urbane, si dhe mungesa e iniciativave dhe mjeteve për angazhime publike.

Megjithatë, viteve të fundit dhe në pergjithësi në qytetet e Kosovës, përkunder zhvillimeve tëe pakontrolluara të ndërtimeve, ndoshta si një "aneë pozitive e paradoksit" vërehen levizje "shpresedhënese" edhe në krijimin dhe menaxhimin e HHP shpesh të nxitura me donacione nga qeveri të ndryshme nga Evropa dhe më tej. Në këtë kontekst edhe qellimi i programit DEMOS, i financuar nga SDC (Swiss Agency for Development and Cooperation) dhe i cili po implementohet nga Helvetas Sëiss Interccoperation është pikërisht nxitja e planifikimit dhe menaxhimit të HHP si një shtytje kyqe për zhvillimin urban tëqyteteve – komunave partnere.

Nga këto HHP të zhvilluara dhe të planifikuara mirë priten përmiresime në shrytezimin racional të tyre dhe në qasjen drejt shërbimeve themelore, ambiente te sigurta, stimulim i aktiviteteve ekonomike dhe i investimeve, promovim i vlerave kulturore dhe historike, ringjallje urbane dhe gjithëpërfshirje, etj.

Një ndër çeshtjet kyqe në planifikimin, krijimin dhe financimin sistematik në HP paraqesin burimet e vogla buxhetore për investime kapitale në përgjithësi dhe një qasje e sistemuar në këtë aspekt do të mundësoje qeverisjes komunale shfrytëzimin meë të mirë të kapaciteteve aktuale përfshire qasjen drejt burimeve të jashtme të financimit. Një plan me prioritete teë percaktuara mirë do të mundesojë përgaditjen e projekteve të reja si dhe zhvillimin dhe avancimin e HHP ekzistuese.

Procesit të perpilimit të planit të investimeve në HHP i prinë grupi punues komunal i ndihmuar nga grupi koordinues i cili përbehet nga drejtorë dhe zyrtarë të larte të departamenteve respektive, ndërsa informacionet e reëndesishme sigurohen nga zyrat gjegjese, nga ndermarrjet publike, si dhe nga shoqeria civile e nga qytetaret të cilet do të nxiten në pjesemarrje aktive duke dhënë ide, propozime, mendime, etj.

### 1.1 Fushëveprimi i Planit të Investimeve në HHP

Plani i investimeve në HHP për komunen e Rahovecit si dokument afatmesëm bazohet në vizionin e qytetit i cili parasheh arritjet afatgjata të komunës në fushen e planifikimit një nga të cilat është ajo e HHP duke përfshirë parqet, hapësirat gjebëruese natyrore, sheshet, terrenet sportive, varrezat, dhe hapësirat e objektet kulturore-historike.

Në këteë kontekst jane hartuar dy plane të posaçme, gjegjësisht, Plani i Mirëmbajtjes se HHP dhe Plani i Investimeve ne HHP.

Që të dy këto dokumente janë nxjerrë nga nje sërë burimesh, përfshire ato si në vijim:

- Vlëresimi i HHP të qytetit nga ana e grupit punues;

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 56 | Parku ne qender te Drenocit | Prioritet i lartë | Rurale | Park |
| 57 | Parku ne Palluzhe | Prioritet i lartë | Rurale | Park |

| Nr. | Emri | Prioriteti | Zona | Kategoria |
|---|---|---|---|---|
| 5 | P.P. Te kroi I Haxhisë | Prioritet i mesëm | Urbane | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 6 | P.P e Deshmorit Agim Qelaj | Prioritet i mesëm | Urbane | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 7 | P.P. Te Qëndresa | Prioritet i mesëm | Urbane | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 9 | P.P. ne Hamovc | Prioritet i mesëm | Urbane | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 10 | P.P. e Tonit dhe Micit në Apterushë | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 11 | Pllaka perkujtimore te shkolla ne Gexhe | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 13 | Pll.per. Te sh. Ne Malesi te Vogel | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 14 | Pll.per. te B. Bekteshi Apterushë | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 20 | Pllaka perkujtimore ne Dabidol | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 21 | Pllaka perkujtimore ne Palluzh | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 23 | Pllaka perkujtimore te Sholla Drenoc | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 25 | Pllaka perkujtimore Bedrush Gashi Drenoc | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 26 | Pllaka perkujtimore e deshmoret e 90 ne Brestoc | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 29 | Pllaka perkujtimore e deshmoreve ne Hoqe te Vogel | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 31 | Pllaka perkujtimore ne koder te fshatit ne Nagac | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 32 | Pllaka perk. ne koder te fsh ne Krushe te Madhe | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 33 | Pll. Perk. ne koder te fsh.ne K te Madhe-Ragip Hoti | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 34 | Pllaka perkujtimore ne koder te Zatriqit | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 36 | Pll perk.e deshmorit Sakip Bellaqa ne Fortese | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 37 | Pll.perk. e deshmorit Gani Paqarizi ne Fortese | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 38 | Pllaka perkujtimore e deshmorit Milaim Krasniqi | Prioritet i mesëm | Urbane | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 50 | Pllaka perkujtimore te shkolla ne Denje | Prioritet i mesëm | Rurale | H.H.P pranë pllakës përkujtimore |
| 51 | Lapidari I deshmoreve Visar Hoti dhe Safet Latifi | Prioritet i | Urbane | H.H.P pranë lapidarit |

### 1.3 Dokumentet referuese per pergaditjen e PIHHP

Plani i investimeve nderlidhet me nevojat dhe kerkesat per HHP ne zonen urbane dhe ate rurale, me kualitetine jetes dhe tenton te promovoje interesat e qytetareve ne komunen e Rahovecit ne pergjithesi. Disa nga dokumentet ne kuader te kornizes ligjore ne te cilat eshte referuar pergaditja e ketij plani:

i. Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2012-2017

ii. Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2016-2018

iii. Plani Zhvillimor Komunal (PZhK), 2013-2023

iv. Plani Zhvillimor Urban, 2013-2018

v. Planet Rregulluese Urbane, te vitit 2010

vi. Ligji Nr. 03/L-040 Per Veteqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e RK / Prishtine: viti III / Nr. 28 / 04 Qershor 2008.

Korniza afatmesme buxhetore 2016-2018, e aprovuar me 29 Qershor 2015, me projektet e parashikuara per investime ne te gjitha zonat e komunes. Ne te vertete, projekte kapitale te cilat permenden ne te jane kryesisht infrastrukture rrugore, ujesjelles, kanalizim dhe objekte publike por jo edhe tipologji te HHP per rekreacion pasiv apo aktiv te qytetareve.

## 2. Situata aktuale dhe planet

### 2.1 Gjendja aktuale ne aspektin e ofertes se HHP sipas tipologjive

Me perditesimin e inventarit te HHP nga ana e grupit punues eshte konstatue se oferta aktuale me 5,82m$^2$/ban per parqe, gjelberime, sheshe dhe terene sportive per zonen urbane eshte ende larg standardeve te synuara dhe se situata tanishme e karakterizuar me mungese te mjeteve financiare ne njeren ane ndersa me kerkese relativisht te madhe per HP ne anen tjeter, kerkon percaktim me kujdes te prioriteteve per projekte te ketyre tipologjive.

Per ilustrim dhe per tu referue me lehte, ketu me poshte jane paraqitur te dhenat e siperfaqeve te HHP per koke banori dhe ky eshte rezultat i hapit te pare te ndermarre nga ana e grupit punues per evidentimin e hapesirave publike:

*Tab. 1 Siperfaqet aktuale e HHP ne qytetin e Rahovecit per tipologjite e trajtuara ne plan*

| HP sipas tipologjise | Siperfaqja ne m$^2$ | Nr. i banoreve | Sip e HP ne m$^2$ / ban. |
|---|---|---|---|
| Parqe / gjelberime | 6944 | 56208 | 0.12 |
| Sheshe | 865 | 56208 | 0.01 |

Gjetjet nga e kaluara tregojne se buxheti komunal per projekte kapitale megjithe efikasitetin e tij nuk ishte burim i vetem per investime ne HHP. Ne te vertete investimet ne HHP gjate vitit te kaluar ishin te mbeshtetura edhe nga grantet qeveritare dhe nga donacionet e jashtme siç ishte edhe projekti i rregullimit hapesirave/trotuareve Hapesirave te hapura Publike ne Komunen e Rahovecit i bashkefinancuar me qeverine zvicerane.

Evidenca e ndarjes se buxhetit per investime ne HP ne vitin 2014 prej 30,600.00€, dhe ajo e vitit 2015, poashtu 30,600.00€, pa rritje fare, shihej si nje rrethane jo lehtesuese per realizimin e projekteve ne periudhen e permendun, perderisa permiresimi i trendit me alokimin buxhetit prej 50,000.00€ per vitin 2016 eshte pak me shpresedhenes dhe tregues se megjithate qeveria komunale ka plane dhe vemendje te perqendruar ne zhvillimin dhe avancimin e HHP. I njejti poashtu nuk mund te konsiderohet si baze solide per nje planifikim real te projekteve, derisa investimet nga qeveria qendrore dhe nga donatore te jashtem serish pritet te zene vend te rendesishem ne kete aspekt.

Ne kete kontekst dhe pas vleresimit se gjendja e tanishme e shumices se hapesirave ekzistuese ne zonen urbane nuk eshte ajo e duhun, rekomandimet jane qe per realizimin e investimeve ne HHP nevojitet nje qasje sistematike dhe te njejtat per periudhen e ardhshme afatmesme do te zhvillohen te orientuara ne dy drejtime:

- investimet ne rehabilitimin/revitalizimin e hapesirave ekzistuese, tab. 3.a, dhe
- investimet ne realizimin e projekteve te reja ne fushen e HHP, tab. 3.b

Pjese perberese te ketij plani mund te jene edhe investimet ne HHP prane objekteve arsimore gjegjesisht hapesirat prane objekteve institucionale por edhe atyre banuese ne qytet.

### 2.3 Plani i investimeve per periudhen afatmesme 2016 – 2021

Investimet prioritare ne HHP te planifikuara per periudhen afatmesme te planit aktual jane pasqyruar ne tabelat ne vijim:

*Tab. 3 Investimet ne HHP ne qytetin e Rahovecit ne zonen urbane (zu), nder(sub)urbane (su) dhe rurale (ru) te planifikuara per periudhen afatmesme 2016-2018*

*Tab. 3.a, Investimet ne revitalizimin e HHP ne qytetin e Rahovecit ne zonen urbane (zu)*

| Nr. ren. | Emri i HHP / investimet e planifikuara ne hehabilitimin e hapesirave ekzistuese | Sip. ne $m^2$ | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | Burimi i financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rruga 28 Nentori | Park/Trotuar | | | | | | |
| 2 | Rruga 28Nentori II | Park/Trotuar | | | | | | |
| 3 | Rruga Gezim Hamza I | Park/Trotuar | | | | | | |
| 4 | Rruga Gezim Hamza II | Park/Trotuar | | | | | | |
| 5 | Rruga M.Ismaili | Park/Trotuar | | | | | | |
| 6 | Troturaret Rruga UQK-se I | Trotuare/Hap.Gjeb./Ndriqim | | | | | | |
| 7 | Troturaret Rruga UQK-se II | Trotuare/Hap.Gjeb./Ndriqim | | | | | | |

**ketu investimet jane shperndare neper vite megjithese opcioni i revitalizimit te te gjitha nente hapesirave brenda nje viti eshte gjithashtu i mundshem.*

riparime, dhe ne pergjithesi masa preventive me qellim te mirembajtjes ne gjendje te deshirueshme per shfrytezim te HHP.

## 3. Vizioni, objektivat dhe strategjia e zhvillimit te HHP

Ashtu si projektimi urban edhe strategjia e zhvillimit te hapesirave publike merret me hapesirat e hapura ne qytet. Qe te dyja keto i qasen HP nga dy kenveshtrime te ndryshme te spektrit. Derisa strategjia e projektimit urban niset nga ambienti i ndertuar, posaqerisht ne qendra te qyteteve, strategjia e HHP perqendrohet ne ambientin e hapur natyror nga i cili ndertesat zakoisht rrethohen. Ato nderthurren pandashem dhe hapesirat me te suksesshme jane gjithnje ato te cilat perbehen nga te dy keto elemente, ndertimet dhe siperfaqet e lira.

Njesite e qeverisjes lokale ne KKL e shohin te rendesishem planifikimin shumevjeçar te investimeve kapitale. Ne kete kontekst me rendesi eshte te definohet edhe kahja drejt planifkimit te investimeve ne HP si pjese e rendesishme e investimeve te pergjithshme.

Bazuar ne konceptin e zhvillimit te teritorit perfshire edhe HHP, si objektiva te pergjithshme dhe ne harmoni me PZhK dhe PZhU lidhur me HP mund te permenden:

- mbrojtja e hapesirave ekzistuese brenda dhe jashte qytetit,
- rehabilitimi i hapesirave ekzistuese te degraduara,
- rregullimi i hapesirave te reja publike
- zhvillimi i korridoreve te gjelberta, ndertimi e rrugeve te reja dhe renovimi e atyre ekzistuese, krijimi i shtigjeve per kembesore, shtigjeve per biçikleta, tampone gjelberimi tek zonat industriale, gjelberime pergjate rrugeve ne zonat banuese, pergjate rrugeve me trafik te dendur, etj.
- reduktimi i intenzitetit trafikut nepermjet promovimit te transportit publik dhe krijimit te kushteve per levizje ne kembe dhe me biçikleta,
- ruajtja e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, etj.

Per dallim nga sektoret e tjere, formimi i HHP kerkon decenije te punes se orientuar dhe parashikimet ambicioze te PZhU per zgjerimin e qytetit ne pjesen perendimore dhe ne ate jug-perendimore mund te vijne ne shprehje vetem ne terma afatgjate te planifikimit.

Dokumentet e nivelit lokal te planifikimit, bazuar ne trendet e zhvillimit dhe te levizjeve te popullsise deri ne kete moment megjithate jane treguar tejambicioze dhe ne dis-harmoni me parametrat reale te projektuar.

### 3.2 Synimet dhe Objektivat specifike

**Synimi 1 - Revitalizimi i HHP ekzistuese**

- Objektivi 1: Revitalizimi i rreth $m^2$ te hapesirave gjelberuese ne vitin 2016, mbi $m^2$ te tyre ne vitin 2017 dhe $m^2$ te tjera ne vitin 2018.
- Objektivi 2: Deri ne vitin 2 te krijohen korridore te gjelberta/dru-rende me rreth cope drunje te mbjellur pergjate trotuareve dhe hapesirave per rreth.

**Synimi 2 - Investimet ne HHP te reja**

***Tabela përmbledhëse e investimeve për periudhën 2016-2021***

| | |
|---|---|
| *Numri I Projekteve* | 7 |
| *Vlera totale e investimeve* | ***109,655*** |
| *Vlera mesatre e investimeve* | ***15,665*** |

| Investimet ne HHP | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vlera investimeve | 16,280 | 80,870 | 7,010 | 5,495 | - | 109,655 |
| ***Ne %*** | ***14.8%*** | ***73.7%*** | ***6.4%*** | ***5.0%*** | ***0.0%*** | ***100.0%*** |

| Burimet e Financimit | Të Hyrat Vetanake | Grante Qeveritare | Total |
|---|---|---|---|
| Vlera investimeve | 38,875 | 70,780 | 109,655 |
| ***Ne %*** | ***35.5%*** | ***64.5%*** | ***100.0%*** |

| Struktura e financimit | Park/Trotuar | Trotuare/Hap. Gjeb./Ndriqim | Total |
|---|---|---|---|
| Vlera investimeve | ***38,875*** | ***70,780*** | 109,655 |
| | ***35.5%*** | ***64.5%*** | ***100.0%*** |

| Katgoria | I lart | Mesatar | U ulet | Total |
|---|---|---|---|---|
| Prioriteti-Investimet | ***16,280*** | ***17,100*** | ***76,275*** | 109,655 |
| ***Ne %*** | ***14.8%*** | ***15.6%*** | ***69.6%*** | ***100.0%*** |

| Kategoria | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Park/Trotuar | 16,280 | 10,090 | 7,010 | 5,495 | - | 38,875 |
| Trotuare/Hap.Gjeb./Ndriqim | - | 70,780 | - | - | - | 70,780 |
| **Total** | **16,280** | **80,870** | **7,010** | **5,495** | **-** | **109,655** |
| ***Ne %*** | ***17.2%*** | ***21.4%*** | ***27.2%*** | ***19.3%*** | ***14.8%*** | ***100.0%*** |

## 4.1.Analiza buxhetore e kostove investive kapitale

Investimet e planifikuara për periudhe 2016-2021 janë ne vlere prej **109.655** euro. Investimet janë te grupuara ne kategori investimeve sipas veçorive e natyrës se HHP-ve.

***Tabela 1:Investimet për periudhën 2016-2021***

| Kategoria | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vlera investimeve | 16,280 | 80,870 | 7,010 | 5,495 | - | 109,655 |
| Ne % | **14.8%** | **73.7%** | **6.4%** | **5.0%** | **0.0%** | **100.0%** |

***Graf 1: Investimet për periudhën 2016-2021***

| Kategoria | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | Total | Ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Park/Trotuar | 16,280 | 10,090 | 7,010 | 5,495 | - | 38,875 | 35.5% |
| Trotuare/Hap.Gjeb./Ndriqim | - | 70,780 | - | - | - | 70,780 | 64.5% |
| Trotuare | 16,280 | 80,870 | 7,010 | 5,495 | - | 109,655 | 100.0% |

*Tabela 4:Investimet e planifikuara e bazuar ne prioritetet për periudhën 2016-2020*

| Katgoria | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | Total | Ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I lart | 16,280 | - | - | - | - | 16,280 | 14.8% |
| Mesatar | - | 10,090 | 7,010 | - | - | 17,100 | 15.6% |
| U ulet | - | 70,780 | - | 5,495 | - | 76,275 | 69.6% |
| Total | 16,280 | 80,870 | 7,010 | 5,495 | - | 109,655 | 100.0% |

*Graf 3: Investimet e planifikuara e bazuar ne prioritetet për periudhën 2016-2020*




*Tabela 5:Investimet e planifikuara e bazuar ne aktiviteteve për periudhën 2016-2020*

| Katgoria | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | Total | Ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| AP-Aktivitetet e Pastrimit | 10,890 | 54,730 | 5,155 | 3,640 | - | 74,415 | 67.9% |
| H-Aktivitetet e Hortikulturës | 5,390 | 26,140 | 1,855 | 1,855 | - | 35,240 | 32.1% |
| Total | 16,280 | 80,870 | 7,010 | 5,495 | - | 109,655 | 100.0% |

*Graf 4:Struktura e investimeve ne baze te aktiviteteve investive për periudhën 2016-2021*




*Tabela 7:Rjedha e parasë për projektet investimeve për periudhën 2016-2021*

| Nr | Projekti | Kategoria | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rruga 28 Nentori | Park/Trotuar | 11,920 | | | | | 11,920 |
| 2 | Rruga 28Nentori II | Park/Trotuar | 4,360 | | | | | 4,360 |
| 3 | Rruga.Gezim Hamza I | Park/Trotuar | | 10,090 | | | | 10,090 |
| 4 | Rruga Gezim Hamza II | Park/Trotuar | | | 7,010 | | | 7,010 |
| 5 | Rruga M.Ismaili | Park/Trotuar | | | | 5,495 | | 5,495 |
| 6 | Troturaret Rruga UQK-se I | Trotuare/Hap.Gjeb./Ndriqim | | 35,390 | | | | 35,390 |
| 7 | Troturaret Rruga UQK-se II | Trotuare/Hap.Gjeb./Ndriqim | | 35,390 | | | | 35,390 |
| | Total | | 16,280 | 80,870 | 7,010 | 5,495 | - | 109,655 |
| | Ne % | | 14.8% | 73.7% | 6.4% | 5.0% | 0.0% | 100.0% |

*Tabela 8:Projektet investimeve për periudhën 2016--2021*

## 5. Monitorimi dhe rishikimi

- Mbikqyrja institucionale nga aspekti i planifikimit hapesinor, teknik dhe investiv do te realizohet nga mbikqyresit profesionale te caktuar nga autoriteti komunal respektiv. Procesi do te jete i hapur dhe transparent per qytetaret dhe per komunitetin. Mbikqyrja e zbatimit te projekteve perfshin vizitat ne teren pergjate dinamikes se zbatimit te projektit percjellur me raporte te rregullta periodike.

Broshurat dhe fletushkat do te jene mjete te perhershme ne promovimin e investimeve ne HHP ne qytetin e Rahovecit.

**Veprimi 3:** Organizimi i aktiviteteve me komunitetin

Aktivitete dhe debate publike do te organizohen ne baza vjetore per te marre kerkesa, komente dhe propozime nga qytetaret per ruajtjen e hapesirave ekzistuese, avansimin dhe krijimin e hapesirave te reja publike.

**Veprimi 4:** Ngritja e kapaciteteve ne hartimin e planeve, projekteve sipas standardeve dhe ligjeve lokale dhe europiane me theks te veçante ne pergatitjen e dokumentacioneve investive teknike si dhe zbatimi i rekomandimeve ligjore ne menaxhimin e kontratave.

Drejtoria per Urbanizem, Sherbimeve Publike, Departamentet e Financave dhe te Prokurimit Publik jane pergjegjese per monitorimin dhe rishikimin e planeve dhe projekteve.

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tereneve Sportive, (zu) | Reja (Opcionale) | | | | | |
| 18 | Rregullimi i HHP pergjate rrugeve | | | | | | |
| 19 | Ndertim Terreneve sportive i planifikuar ne faza | | | | | | |

| | Investime te reja, z. rurale | Statusi i HHP | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 20 | Trotuare (zr) | Investime te reja ne HHP | | | | | |
| 21 | Trotuare (zr) | | | | | | |
| 22 | Trotuare (zr) | | | | | | |
| 23 | Trotuare (zr) | | | | | | |
| 24 | Tereneve Sportive (zr) | | | | | | |
| 25 | Trotuare (zr) | | | | | | |
| 26 | Trotuare (zr) | | | | | | |
| 27 | Trotuareve (zr) | Investime te reja ne HHP | | | | | |
| 28 | Terene Sportive Shkollore | | | | | | |
| 29 | Tereneve Sportive, (zr) | | | | | | |
| 30 | Shtrat i lumit (zr) | | | | | | |
| 31 | Trotuare (zr) | | | | | | |
| 32 | Trotuare (zr) | | | | | | |
| 33 | Trotuare (zr) | | | | | | |
| 34 | Tereneve Sportive (zr) | | | | | | |
| 35 | Shtratit i Lumit (zr) | | | | | | |

**Rekomandime:**

Rekomandohet qe brenda institucioneve, ne komunitete, tek shoqerite civile, etj. te nxitet dhe te promovohet te menduarit drejt ruajtjes se ambientit dhe hapesirave publike, te behen organizime ku qytetare dhe shoqata te ndryshme mund te shprehin ide dhe projekte lidhur me HHP.

Departamentet gjegjese dhe institucionet ne pergjithesi, me aktivitete te perbashketa te jene afer qytetareve duke deshmuar se ato jane aty per tu kujdesur per ta. Planifikime ne kete kontekst mund te behen ashtu siç eshte permendur me larte ne kuader te kapitullit 5.

Rekomandime lidhur me HP mund te jene zhvilluar ne varesi nga gjetjet ne teren, nga analiza e gjetjeve aktuale, duke pasur parasysh menyren dhe pengesat per te zhvilluar HHP ne menyre te qendrueshme, si dhe nga debatet ne komitetet gjegjese te KK dhe ato me qytetaret te cilat planifikohen te organizohet para aprovimit te PIHHP ne KK te Rahovecit.

**Fakte kyqe per PIHHP**

- Autoriteti pergjegjes: Kuvendi Komunal i Rahovecit
- Lende e Planit: PIHHP ve ne pah qellimet dhe objektivat e qeverise komunale lidhur me HHP ne zonen urbane, nderurbane (si dhe ne ate rurale?).
- Periudha e mbuluar me PIHHP: 5 vjeçare, ndersa parashihet qe te rishikohet, plotesohet dhe ndryshohet sipas nevojes ne baze te monitorimit vjetor.
- Qellimi dhe/apo objektivat e PIHHP: Qe ne menyre efikase te planifikoje zhvillimin, ruajtjen, dhe permiresimin me sukses te HHP perfshire zonat e gjelberta, ato rekreative, sheshet, ne te gjitha periudhat, si dhe te planifikoje siperfaqet e nevojshme te hapesirave ne periudhen afatmesme.
- Identifikimi i mungesave eventuale ne aspektin e mbulimit te zonave me HP, ne ate te qasjes per grupmosha te ndryshme, persona me aftesi te kufizuara, qasje emergjente, etj.
- Kontaktet: KK Rahovec, Drejtoria e Sherbimeve Pubike, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria per Urbanizem Planifikim dhe Mbrojtje te Mjedisit.